



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**QENDRA E BOTIMEVE
PËR DIASPORËN**

Nr. 269 prot.
Tiranë, më 01.10.2020

**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORI DHE
FILOLOGJISË**

Nr. 4921 prot.
Tiranë, më 01.10.2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

Qendra e Botimeve për Diasporën me adresë: Rruga “Vilat Gjermane” Vila nr.6, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori i institucionit Znj. Mimoza Hysa Çuliqi

dhe

Fakulteti i Histori dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës me adresë: “Rruga e Elbasanit”, Tiranë, Shqipëri përfaqësuar nga Dekani i Fakultetit Z. Sabri Laçi

BAZA LIGJORE

Për Qendrën e Botimeve për Diasporën

Për Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës:

Ligji i Arsimit të lartë 2015, neni 42, pika 2;
Statuti i Universitetit të Tiranës 2018, neni 12, pika 5.

PREAMBUL

Qendra e Botimeve për Diasporën në Shqipëri dhe Fakulteti i Histori dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës (në vijim referuar si Palët),

Duke vlerësuar rëndësinë e përhapjes, studimit dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë;

Me dëshirën për të bashkëpunuar në fushën e botimeve dhe studimeve për diasporën në funksion të interesit të ndërsjellë të palëve;

Me synimin për të koordinuar punën për studimet, kërkimin shkencor si dhe krijimin e mundësive alternative të mësimin të gjuhës shqipe në diasporë;

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur Marrëveshje.

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës dhe realizimin e studimeve në nxitjen e mendimit shkencor të specializuar për gjuhën, letërsinë, historinë dhe kulturën shqiptare në diasporë. Ato do të koordinojnë veprimtarinë e tyre duke i dhënë një rëndësi të veçantë kërkimit, hulumtimit dhe studimit të mundësive për ruajtjen, përhapjen dhe promovimin e gjuhës shqipe si dhe të kulturës shqiptare në diasporë.

Neni 2 **Objekti i bashkëpunimit**

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për:

- a. Hartimin, përzgjedhjen, përshtatjen, përmirësimin e teksteve shkollore dhe literaturës plotësuese për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë;
- b. Ofrimin e përvojës për didaktikën e mësimdhënies së gjuhës shqipe jashtë vendit si dhe përgatitjen e materialeve didaktike të mësimdhënies në shërbim të një platforme digjitale të mësimin të gjuhës shqipe;
- c. Organizimin e aktiviteteve dhe konferencave të përbashkëta shkencore për trajnimin e mësuesve në diasporë;
- d. Krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta në thirrjet e projekteve të publikuara nga donatorë të ndryshëm;

Neni 3 **Përgjegjësitë e palëve**

Bashkëpunimi sipas kësaj marrëveshjeje do të funksionojë si vijon:

Qendra e Botimeve për Diasporën do të realizojë:

- a. Krijimin e një platforme digjitale të mësimin të gjuhës shqipe për shqiptarët e diasporës;
- b. Publikimin e materialeve didaktike (tekste shkollore, literaturë plotësuese, video shpjeguese) në platformën digjitale;
- c. Botimin e studimeve të kryera në fushën e mësimdhënies së gjuhës dhe kulturës shqiptare;

- d. Realizimin e aktiviteteve vjetore dhe konferencave shkencore me fokus mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare;

Fakulteti i Histori dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës do të realizojë:

- a. bashkëpunimin midis **Fakultetit të Histori dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën;**
- b. bashkërendimin e ekspertizës duke angazhuar stafin akademik dhe studentët për përgatitjen e materialeve didaktike, teksteve shkollore në ndihmesë të krijimit dhe funksionimit të platformës digjitale të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë;
- c. Bashkëpunimin në organizimin e trajnimeve për mësuesit e gjuhës shqipe të diasporës;
- d. Bashkëpunimin në botimin e materialeve didaktike për mësimdhënien e gjuhës shqipe në diasporë.
- e. Vënien në dispozicion të mjediseve dhe të literaturës së Bibliotekës së Fakultetit.
- f. Vënien në dispozicion të infrastrukturës së Fakultetit për kryerjen e takimeve, konferencave etj.

Neni 4

Zbatimi i marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht zbatimin e marrëveshjes nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim, në përfundim të çdo viti kalendarik.
2. Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurinë e aktiviteteve trajnuese të zhvilluara gjatë një viti kalendarik edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara

Neni 5

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditëve.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin me njëra-tjetrën me qëllim koordinimin e veprimeve, që duhet të ndërmerren bashkërisht rast pas rasti.

3. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje **Qendra e Botimeve për Diasporën** ka të drejtë të komunikojë drejtpërdrejtë me **Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës** për bashkëpunime konkrete, por në çdo rast do të informojë Dekanin e Fakultetit, si autoriteti më i lartë i këtij institucioni dhe përfaqësues i tij me të tretët.

Neni 6 **Kostot financiare**

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Palët kanë në dispozicion.

Neni 7 **Kohëzgjatja e dhe ndryshimi**

Kjo marrëveshje nënshkruhet për një afat kohor të pacaktuar. Ai mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje mes palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 8 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 9 **Hyrja në Fuqi**

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë **Qendrës së Botimeve për Diasporën** dhe dy pranë **Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës**.

Nënshkruar në Tiranë, më 01.10.2020.

**QENDRA E BOTIMEVE
PËR DIASPORËN**

DREJTOR

MIMOZA HYSA ÇULIQI



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORI DHE
FILOLOGJISË**

DEKAN

Prof. Dr. SABRI LACI

